



**AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË  
DHE INOVACIONIT**

**AKTIVITETI:**

TAKIM ME PËRFAQËSUES TË  
PROGRAMIT EVROPIAN EUREKA

<b>DATA AKTIVITETIT</b>	<b>E</b> 13 .Dhjetor .2010 14 .Dhjetor .2010
<b>VENDI</b>	AKTI, Tiranë, Shqipëri
<b>OBJEKTIVAT</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi i Programit EUREKA</li> <li>- Statusi i Shqipërisë si Pikë Kombëtare Informacioni në EUREKA</li> <li>- Mundësitë e përfshirjes së Shqipërisë në Programin EUREKA</li> </ul>
<b>DELEGACIONI EUREKA</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Z. Luuk Borg</b>, Drejtor i sekretariatit të EUREKAS</li> <li>2. <b>Z. Halada Svatopluk</b>, Koordinator për Ballkanin pranë EUREKA</li> </ol>
<b>PERSHKRIMI</b>	<p>Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, në kuadër të përmbushjes së misionit për promovimin, koordinimin dhe ofrimin e ekspertizës për Programe dhe Projekte të iniciuara nga Bashkimi Evropian ka shprehur interesin e saj për përfshirjen e Shqipërisë në Programin EUREKA.</p> <p>EUREKA është një rrjet ndërqeveritar i themeluar për të mbështetur: orientimin e tregut drejt kërkimit dhe zhvillimit, projektet novatore në fushën e industrisë, orientimin e qendrave kërkimore dhe universiteteve</p>

**ANEKS**

drejt gjithë sektorëve teknologjikë.

Në këtë kuadër u konsiderua me rëndësi organizimi i një takimi me përfaqësuesit e Programit EUREKA për diskutimin e mundësive të pjesëmarrjes së Shqipërisë në këtë program si dhe hartimin e një plan veprimi për promovimin e programit.

Gjatë dy ditëve të qëndrimit të Delegacionit EUREKA në Shqipëri, AKTI organizoi disa takime me autoritete Shqiptare të interesuar për Programin si dhe një Tryezë të Rrumbullakët për prezantimin e Programit me përfaqësues të disa Kompanive, Industrive dhe Sipërmarrjeve të vogla e të mesme.

**TAKIMET ME AUTORITET SHQIPTARE**

Takimi i parë u mbajt në datën 13.12.2010 pranë Akademisë së Shkencave, në të cilën delegacioni u prit nga **Prof. Dr. Gudar Beqiraj**, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe nga **Prof. Dr. Salvator Bushati**, Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave.


Akademia e Shkencave ishte e njohur me programin EUREKA dhe në vitin 1992, vit në të cilin Shqipëria ka marrë edhe statusin e Pikës Kombëtare të Informacionit , Akademia e Shkencave së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kishin organizuar Ditë Informativë në kuadër të këtij programi.

Pas kësaj periudhe Akademia e Shkencave ka aplikuar në dy projekte EUREKA, të cilët nuk kanë arritur të rezultojnë të suksesshëm.

Në datën 14.12.2010, **takimi i parë** u realizua me **Z.Gjegj Buxhuku**, Administrator i Përgjithshëm Konfindustrisë Shqiptare.

Pjesa e parë e takimit u fokusua në prezantimin e EUREKËS nga dy përfaqësuesit e saj, Z.Luuk Borg dhe Halada Svatopluk, dhe më pas Z.Buxhuku u shpreh i interesuar për përfshirjen e biznesit Shqiptar në këtë Program duke theksuar se Bizneset Shqiptare kanë potencial për tu përfshirë në projektet e EUREKËS.

I rëndësishëm ishte fakti se në këtë takim Z.Buxhuku ftoi EUREKEN të



bëhet pjesë e panairit vjetor të organizuar nga KONFINDUSTRIA.

Panairi “INDUSTRI, TEKNOLOGJI DHE ENERGJI” do të mbahet në datat 29 Prill 2011 – 2 Maj 2011 dhe Agjencia e Kërkimit Teknologjisë dhe Inovacionit do të përfaqësohet me standën e vet në këtë panair.

Nisur nga ky fakt gjatë ditëve të panairit do të organizohen Tryeza të Rrumbullakëta me tematika të ndryshme, ndër të cilat do të jetë edhe prezantimi dhe njohja e këtij Programi nga Biznesi Shqiptar.

EUREKA u ftua të ketë standën e vet në panair, të organizojë takime si dhe të sjellë eksperiencën të suksesshme nga vendet e rajonit në projektet e saj.

**Takimi i dytë** u organizua me **Z. Ilir Zhilla**, Kryetar i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, i cili u tregua shumë i gatshëm për të bashkëpunuar në zhvillimin e biznesit duke i dhënë këtij të fundit mundësi të përfshihet në Programe Evropiane me interes jo vetëm për biznesin individual por edhe më gjerë për shoqërinë shqiptare.

**Takimi i tretë** u mbajt në Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) ku **Prof.Dr.Ylli Pango**, Drejtor i Përgjithshëm i AKTI-t theksoi rolin e agjencisë për promovimin, mbështetjen dhe koordinimin e Programit EUREKA në Shqipëri.

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit në rolin e Pikës Kombëtare të Informacionit do të hartojë një plan pune për organizimin e një sërë aktiviteteve për promovimin e Programit EUREKA dhe ndërgjegjësimin e Biznesit, Universiteteve dhe Institucioneve Kërkimore për t’u përfshirë në projektet e EUREKES.

**Takimi i katërt** u mbajt nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës **Z. Myqerem Tafaj**, në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Në këtë takim të rëndësishëm të dyja palët theksuan se me krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit situata e



deritanishme në lidhje me Programin EUREKA do të ndryshojë duke shpresuar se këto janë hapat e para dhe procesi i përfshirjes në programin EUREKA është një proces i gjatë dhe që kërkon një punë të vazhdueshme ndërgjegjësimiti.

Z.Myqerem Tafaj e përgëzoi delegacionin dhe AKTI-n për nismën e ndërmarrë.

Pjesa e dytë e datës 14.12.2010 përfundoi me një Ditë Informativë pranë ambienteve të AKTI-it ku ishin të ftuar të merrnin pjesë përfaqësues të kompanive dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme në Shqipëri.

Z. Halada Svatopluk bëri një përmbledhje të programit, të mundësive që Shqipëria ka për të qenë pjesë e këtij programi dhe më pas kaloi në çështje teknike duke përshkruar fazat që kërkohen për shkrimin e një projekti të suksesshëm EUREKA.

- Fotografi te aktivitetit
- Lista e Pjesëmarrësve

**AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

**TAKIMI ME MINISTRIN E ARSIMIT DHE SHKENCËS Z. MYQEREM TAJAJ**



AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT



AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT



AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

PROGRAMI EUREKA  
 E Martë 14. Dhjetor: 2010 ora 14.30  
 Qendra e Trajimeve.  
 Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit

EMER / MEMËR	INSTITUCIONI	E-MAIL	TEL/CEL	FIRMA
TGURTA HORHA	EMTI	albanianinstitute@gmail.com	0672048132	
MAYLUNDA DEBPOT	VODAFONE ALBANIA	maylinda.debpot@vodafone.al	0692225521	
KUTITIN ICDRIKU	BINDI	kuqtra.kupita@bindi.al	0699068165	
EJLIS ZETELAJ	BINDI	eilis.zetelaj@bindi.al	0692055270	
FATIMIA SHEHU	UNIVERSITETI BULGARI, TIRANES FAKULTETIUS FALORING-SHEDU@yaboo.it		0684018686	
DARDAN SHEHDULLA	UBI, FAKULTETI I MATE VEZENTIMARE	dardan@shehdulla.com	0654083809	
HELENADES SHALSI	Qendra per Evojucion e Energjive Shkencor	helena@ec.org.al	0682882126	
SPIRO THEODORZANI	UNIVERSITETI POLITEKNIK F.G.M	s.theodorzani@yahoo.ca, id.06824087044		
IOA KOSTAJ	Fondacioni 'Biznesit as Yopet' fbu@albania.com	ioa@albania.com	0652109686	